

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses M. R., nga Prishtina, të cilën e përfaqëson N. P., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës B. E., Prishtinë, të cilën e përfaqësojnë F.B., dhe T. G., për shkak të anulimit të vendimit, kompensimit të të ardhurave personale dhe kthimit në punë, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.4300/2016 datë 9.1.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7.8.2018, merr këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.4300/2016 datë 9.1.2018.

Aktgjykimi i cituar ndryshohet vetëm përkitazi me kamatën ashtu që detyrohet e paditura që paditëses shumë e aprovuar t'ia paguajë me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar mbi 1 (një) vit, duke filluar nga data 30.6.2016 e deri në pagesën definitive.

#### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.4300/2016 datë 9.1.2018, janë refuzuar si të pabazuara ankesa e paditëses dhe ankesa e të paditurës, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Prishtinë, C.nr. 3356/2015 datë 30.6.2016, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditëses. Me pjesën II të dispozitivit është vërtetuare se vendimi i të paditurës me numër protokollit ..., datë ..., është i kundërligjshëm dhe si i tillë anulohet. Me pjesën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses t'ia

kompensojë të ardhurat personale të cilat do t'i realizonte nga marrëdhënia e punës, nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës 1.11.2012, e deri në skadimin e kontratës së punës 31.1.2014, nga 1700 € bruto për çdo muaj, në shumën e përgjithshme prej 25.500,00 €, me kamatë ligjore nga data e parashtrimit të padisë më 24.10.2012, e deri në pagesën definitive. Me pjesën IV të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses me të cilën ka kërkuar detyrimin e të paditurës për kompensimin e pagave pas skadimit të kontratës së punës, respektivisht deri në kthimin përfundimtar të paditëses në marrëdhënie pune të paditura. Me pjesën V të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumën e parave prej 640 €.

Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjyqimet e kundërshtuara të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjyqimin e goditur konform dispozitës së nenit 215 të LPK dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në bazë të kontratës nr. ..., datë ..., paditësja ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën në kohë të caktuar, duke filluar nga data 1.2.2011 e deri më 31.1.2014, në vendin e punës Udhëheqëse e Departamentit të Shitjes dhe Marketingut, me pagën bruto prej 1700 € në muaj. Me lajmërimin e datës 11.6.2012 paditësja është njoftuar se në mbledhjen e Bordit Drejtues të Bankës, më 16.5.2012 është aprovuar sistematizimi i ri dhe Departamenti i Marketingut shuhet dhe bëhet Njësi e Marketingut në kuadër të Departamentit të Shitjes, andaj pozita e paditëses shuhet ashtu që ajo kalon në pozitën e Udhëheqëses së Njesisë së Marketingut, me ç'rast është ulur edhe paga nga 1700€ në 1100 €. Drejtori ekzekutiv me letrën e brendshme nr. ..., më datë ..., njofton paditësen se pasi që e njëjta nuk ka pranuar ta nënshkruaj njoftimin për ndryshimin e pozitës së punës, suspendohet me pagesë 50% të pagës bruto, deri në shqyrtimin dhe marrjen e vendimit nga Komisioni Disiplinor. Pas rekomandimeve të dala nga komisioni disiplinor, drejtori ekzekutiv me vendimin nr. ..., datë ..., shfuqizon vendimin nr..., datë ... , për suspendim nga puna me pagesë prej 50% të pagës bruto dhe

paditëses i njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës për periudhën kohore të suspendimit konform dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe akteve të brendshme të bankës. Më datë ..., me vendimin nr. ..., drejtori ekzekutiv paditëses ia ndërpreu marrëdhënien e punës nga data ..., me arsyetim se me kualifikimin e saj nuk ka mund të sistematizohet në vend të ri të punës i cili do t'i përgjigjet kualifikimit të saj. Duke shqyrtuar ankesën e paditëses, Bordi Drejtues i Bankës me vendimin nr. ..., datë ..., ka refuzuar ankesën e paditëses, ndërsa ka fuqizuar vendimin e drejtorit ekzekutiv për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pas së cilës paditësja ka kërkuar mbrojtjen ligjore sipas padis së ushtruar në gjykatë.

Gjykata e shkallës ë parë pas administrimit të provave ka gjetur se e paditura në rastin konkret me marrjen e vendimit për ndryshimin e pozitës së punës së paditëses, gjegjësisht me rastin e vendosjes për uljen e pagës, ka vepruar në mënyrë jo objektive dhe në kundërshtim me nenin 17 par. 2 të Ligjit të Punës nr.03- L-212, duke anashkaluar kërkesat tjera ligjore- siç është aftësia për punë dhe niveli i njëjtë i pagës, nga i cili fakt ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës ka gjetur se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejt, i bazuar në ligj dhe shkresat e lëndës, si dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme në aktgjykimin e ankimuar, pastaj ka refuzuar ankesën si të pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Në aktgjykimet e tyre ato kanë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Pretendimin se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të shkeljes së dispozitës ligjore nga neni 182 par. 1 e 2 pika (n) të LPK –ës, sepse në faqen 3 paragrafi 6 të aktgjykimin arsyetimi është kontradiktor me faktet relevante, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase, konstatimi i cekur në këtë pjesë të aktgjykimin është në harmoni me gjendjen faktike dhe faktet e prezantuara në shkresat e lëndës, sepse nuk ka qen kontestuese se paditësja nga e paditura është njoftuar për sistematizimin e ri , ndërrimin e pozitës së punës dhe zvogëlimin e pagës, ashtu siç është cekur në aktgjykim, andaj pretendimi i cekur në revizion se e

paditura është munduar me gjete marrëveshje për sistematizimin e paditëses por e njëjta ka refuzuar ta nënshkruaj, nuk paraqesin shkelje të dispozitës ligjore të cekur më lartë, ngase nuk ka rrethana të cilat argumentojnë se arsyetimi i aktgjykimi është në kundërshtim me faktet relevante.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se konstatimi i gjykatës së shkallës së dytë se me rastin e shkëputjes së kontratës së punës e paditura nuk ka respektuar procedurën e cila është paraparë me Ligjin e Punës, për çka vendimi është i paligjshëm, si të drejt e të bazuar në ligj e vlerëson edhe kjo gjykatë e revizionit, ngase paditëses i është shkëputur kontrata e punës në kundërshtim me nenin 70 1.1 të Ligjit të Punës dhe nenit 17.2. të ligjit të cekur, sepse i punësuari në rast të nevojës apo organizimit të ri të punës, në pajtim me kontratën e punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me kontratën e punës, ndërsa në rastin konkret njoftimi për ndërrimin e pozitës së punës nuk ka qenë sipas kriterit të nenit të cekur. E paditura nuk ka mundur që me një njoftim paditëses t'ia ndryshojë pozitën e punës sepse sipas par. 1 të nenit 17 të Ligjit të punës, i punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur kontratë pune, andaj pretendimet e cekura në revizion se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale nga kjo Gjykatë u vlerësua si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi edhe thëniet e revizionit se paditësja në bazë të kualifikimit shkollor të saj nuk i ka plotësuar kushtet objektive për sistematizimin e saj në ndonjë vend tjetër të punës dhe niveli i pagës i është caktuar konform politikave dhe procedurave të burimeve njerëzore, por kjo nuk ndikojë që kjo gjykatë të vendosë ndryshe, sepse siç është cekur më lartë e paditura me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenet e cekura të Ligjit të Punës dhe në kundërshtim me nenin 6 të Rregullores për Sistematizim, në të cilën është paraparë se sipas kontratës për punë dhe ndryshimi i pagës rregullohet ekskluzivisht me aneks kontratë, gjithashtu Drejtori Ekzekutiv i bankës sipas sistematizimit të vendeve të punës nuk ekziston andaj edhe nga kjo bazë vendimi i marrë për shkëputjen e kontratës së punës është jo ligjor.

Me revizion nuk është kontestuar detyrimi i të paditurës që paditëses t'ia paguaj shumën e cekur sipas pjesës III të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe lidhur me kamatën, por kjo Gjykatë duke shqyrtuar sipas detyrës zyrtare vlerëson se, nga fakti që është vërtetuar se vendimi i të paditurës për ndërprerjen e kontratës së punës është i kundërligjshëm

dhe si i tillë është anuluar, qëndron detyrimi i të paditurës që paditëses t'ia kompensojë të ardhurat personale të cilat do t'i realizonte nga marrëdhënia e punës, nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës 1.11.2012, e deri në skadimin e kontratës së punës 31.1.2014, nga 1700 € bruto për çdo muaj, në shumën e përgjithshme prej 25.500,00 €, me kamatë ligjore nga data e parashtrimit të padisë më 24.10.2012, e deri në pagesën definitive.

Lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, andaj si pasojë patën ndryshimin e saj, ashtu që paditëses shuma e caktuar duhet t'i paguhet me kamatë në lartësi të depozitimeve kursimore të paafatizuara të cilat paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar mbi 1 (një) vit nga data 30.6.2016 e deri në pagesën definitive.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 dhe 224 par. 2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.213/2018, më 7.8.2018

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku